



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATURA E SHTETIT
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. 380/9 Prot.

Datë 24 / 6 / 2025

URDHËR

Nr. 350, datë 24.6.2025

“PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT PËR KRYERJEN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË
FIGURËS SË KANDIDATËVE TË SHPALLUR FITUES NË PROVIMIN E PRANIMIT
TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS PËR POZICIONIN AVOKAT SHTETI NË
NIVEL VENDOR”

Në mbështetje të neneve 6 gërma “a” dhe 20 të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar midis Avokaturës së Shtetit dhe Shkollës së Magjistraturës me nr. 380/2 prot., datë 10.02.2025, shkresës nr. 701 prot., datë 20.05.2025 të Shkollës së Magjistraturës dhe urdhrit nr.330, datë 05.06.2025 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komisionit për kryerjen e procedurës së verifikimit të kandidatëve të shpallur fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për pozicionet avokat shteti në nivel vendor ose pranë ministrive, me këtë përbërje:

Znj. Florinda Ibrahim – Avokat Shteti pranë Zyrës së Përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhin ndërkombëtar – Kryetare

Znj. Erinda Misho – Avokat Shteti pranë Zyrës së Përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhin ndërkombëtar – Anëtare

Znj. Anjeza Koleka – Specialist i burimeve njerëzore pranë Avokaturës së Shtetit – Anëtare.

2. Komisioni të kryejë procedurën e verifikimit të figurës së kandidatëve për avokatë shteti sipas urdhrit nr.330, datë 05.06.2025 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit dhe legjislacionit në fuqi.
3. Komisioni, të kryejë njoftimin e kandidatëve për fillimin e procedurës së verifikimit të figurës, për Kryetarin dhe anëtarët e komisionit, si dhe për të drejtën që kanë për të kërkuar përjashtimin e tij dhe/ose të çdo anëtari tjetër të komisionit, jo më vonë se 3 ditë nga njoftimi ose nga marrja dijeni e shkakut të përjashtimit.
4. Komisioni t’ju dërgojë kandidatëve në rrugë elektronike formularët e deklarimit dhe vetëdeklarimit, formularin autorizues për dhënien e miratimit për përpunimin e të dhënave personale dhe formularin autorizues për verifikimin, pranë çdo subjekti publik dhe privat,

brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave që lidhen me verifikimin e figurës së kandidatëve.

5. Komisioni të përgatisë shkresat standarde për kërkimin e informacionit nga subjektet publike dhe private, si dhe të shpjegimeve përkatëse nga kandidati, në lidhje me verifikimin e figurës.
6. Në përfundim të procedurës së verifikimit të figurës, Kryetari i Komisionit të paraqesë relacionin përfundimtar me përshkrimin e të dhënave që rezultojnë për çdo kandidat, në lidhje me verifikimin e figurës dhe projektvendimin përkatës të verifikimit.
7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, znj. Florinda Ibrahim avokat shteti, znj. Erinda Misho avokat shteti dhe znj. Anjeza Koleka specialist i burimeve njerëzore.
8. Ngarkohet zyra e arkivit dhe protokollit për komunikimin e këtij urdhri dhe specialisti i IT-së për publikimin e këtij urdhri në faqen elektronike zyrtare të Avokaturës së Shtetit.

Ky urdhër hyn në fuqi pas publikimit në faqen elektronike zyrtare të Avokaturës së Shtetit.

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

